

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës
Qeveria lokale i ndërton rrugët lokale me participim

26 shtator 2012, Prizren

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar një varg konkluzionesh.

Qeveria komunale e Prizrenit ka miratuar propozimin e DSHP-së për shpalljen e tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale, me elemente betoni, me participim (rrugët: "Gjirokastra", "Transit-Terpeticë", "Bajram Curri", "Flamuri", Landovicë dhe Lukinaj). Në këtë takim është miratuar edhe një propozim tjetër i DSHP-së për studimin e fizibilitetit të trafikut urban në komunën e Prizrenit, në mënyrë që të hapet rruga për Partneritetin Publiko-Privat.

Ekzekutivi lokal i ka dhënë dritën e gjelbër Drejtorisë së Administratës për inicimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të ish-objektit të DKA-së për nevojat e Rektoratit dhe të Administratës së Universitetit të Prizrenit. Po ashtu është miratuar propozimi i DUPH-së për ndarjen e një lokacioni për nevojat e UPZ-së. Që të dy këto propozime do t'i procedohen KPF-së dhe KK-së për miratim.

Drejtorja e Administratës ka marrë pëlqimin edhe për shpalljen e tenderit për renovimin e pjesës së dytë të Qendrës për Shërbim të Qytetarëve, që përfshin zyrat e Inspektorateve, Turizmit, të ZKK-së, etj.

Po ashtu është miratuar propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve për formimin e komisionit për verifikimin dhe vlerësimin e gjendjes faktike të krijuar nga uji i ndotur i reparacioneve në Zonën Kadastrale Tupec, në vendin e quajtur "Livadhet e Egra".

Në bazë të propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë është lejuar shitja me ankand e masës drunore të konfiskuar nga autoritetet përkatëse pyjore gjatë periudhës janar-shtator 2012, sikurse edhe lejimi i mjeteve për organizimin e manifestimit "Qethja e Deleve", në shumën prej 2 mijë eurosh.

Sipas kërkesës së Drejtorisë për Emergjencë dhe Siguri janë lejuar mjetet financiare në shumë prej 8 mijë e 160 eurosh për pagesën e trajnimit të zjarrfikësve nga ana e OJQ-së "Paqe Prosperitet dhe Vlera".

Qeveria komunale e Prizrenit me propozimin e Drejtorisë për Turizëm ka lejuar shpalljen e tenderit për realizimin e projektit hulumtues dhe promovues për zejete e vjetra dhe artizanatet.

Është miratuar edhe propozimi i DKRS-së që komuna e Prizrenit të mbështes manifestimin e "Ditëve të Boshnjakëve" me 2 mijë euro.

Në fund, qeveria komunale është dakorduar që rregullorja për ndarjen e subvencioneve të procedohet për miratim në KPF dhe në KK.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org. Projekti përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova, Nr. 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +381 29 222 771



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit" prej muajit shtator 2012 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.